

VENDIM
Nr. 246, datë 20.4.2022

**PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË PROGRAMIT KOMBËTAR PËR KUJDESIN
E SHIKIMIT PËR FËMIJËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët si një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, me qëllim identifikimin e hershëm të dëmtimeve të shikimit dhe parandalimin e problematikave të shikimit e dëmtimeve të tjera të shikimit.

2. Objektivat e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët do të arrihen me ndjekjen e këtyre hapave:

- a) Programi Kombëtar i Depistimit në etapat, si më poshtë vijon:
 - i. të porsalindurit;
 - ii. në 6-mujorin e dytë të vitit të parë të jetës deri në 3 vitet e para të jetës;
 - iii. depistim periodik në moshat nga 4–14 vjeç;
- b) vlerësimi okulistik/optometrik bazuar në protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) përgatitja e një regjistri kombëtar për problemet e shikimit të fëmijëve.

3. Depistimi të të porsalindurit kryhet nga neonatologët, në maternitetet publike ose jopublike, sipas protokolleve të përcaktuara. Nëse konstatohen probleme, njoftohet prindi dhe rekomandohet për ekzaminim të specializuar.

4. Depistimi në 6-mujorin e dytë të lindjes kryhet nga mjekët pediatër/të familjes në konsultorin e fëmijës, në qendrat e konsultorit në të gjithë vendin. Fëmijët që shfaqin probleme rekomandohen nga mjeku i familjes për ekzaminim të specializuar.

5. Depistimi deri në moshën 4 (katër) vjeç kryhet nga mjekët e familjes në qendrat shëndetësore dhe nga mjekët e konsultorit të fëmijës. Paraqitja e fëmijës në konsultor për vaksinat, sipas kalendarit të vaksinimit, shoqërohet edhe me depistimin për shikimin. Depistimi dokumentohet në regjister.

6. Fëmijët që rezultojnë me problematika gjatë depistimit rekomandohen nga mjeku i familjes për ekzaminim të specializuar.

7. Përpara regjistrimit në klasë të parë, për fëmijën duhet të kryhet depistimi nëpërmjet vizitës okulstike/optometrike.

8. Për moshën 6 (gjashtë) deri në 14 (katërmëdhjetë) vjeç, depistimi, sipas udhëzimeve, kryhet në shkollë nga mjekët e shkollave dhe, në mungesë të personelit shëndetësor në shkolla, depistimi kryhet nga mjekët e familjes, sipas zonave përkatëse që mbulon qendra shëndetësore.

9. Gjatë depistimit, personeli shëndetësor dokumenton rezultatet e depistimit në një regjister të veçantë me të dhënat bazë të nxënësit.

10. Fëmijët, që rezultojnë me probleme gjatë depistimit, rekomandohen nga personeli shëndetësor/mjeku i familjes për vizitë të specializuar.

11. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë planin e shtrirjes së programit, sipas etapave të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

12. Organizimi i programit të depistimit të shikimit për fëmijët ndiqet e monitorohet nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

13. Të dhënat për çdo përfitues të këtij programi analizohen nga Instituti i Shëndetit Publik pas raportimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

14. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe spitalet gjinekologjike e obstetrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama